URDHËR
Nr. 561, datë 4.6.2025

PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË MURTAJËS SË RUMINANTËVE TË VEGJËL

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në shkronjën "b", të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminatëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panaire dhe grumbullime të tjera.
2. Ndalimi i lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe specieve të tjera të mbarështuar në fermën e prekur nga sëmundja.
3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël.
4. Forcimin e masave të biosigurisë.
5. Kafshët e llojit të imëta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluara nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.
6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privat dhe shërbimit veterinar shtetëror.
7. Masat e sipërcituara nga pika 1 deri në pikën 6 zbatohen në territorin e:

Nr.	RRETHI	NJËSIA ADMINISTRATIVE	FSHATI
1	Shkodër	**3 km**	
2	Shkodër	Postribë	Kullaj
3	Shkodër	Postribë	Dragoc
4	Shkodër	Postribë	Boks
5	Shkodër	Postribë	Drisht
6	Shkodër	Postribë	Domen
7	Shkodër	**10 km**	
8	Shkodër	Postribë	Mes
9	Shkodër	Rrethina	Hot i Ri
10	Shkodër	Postribë	Muselim
11	Shkodër	Rrethina	Bardhaj
12	Shkodër	Rrethina	Dobrac
13	Shkodër	Gur i Zi	Rrens
14	Shkodër	Gur i Zi	Gajtan
15	Shkodër	Gur i Zi	Rragan
16	Shkodër	Gur i Zi	Gur i Zi
17	Shkodër	Postribë	Vilëz
18	Shkodër	Gur i Zi	Mazrek
19	Shkodër	Shllak	Barcoll
20	Shkodër	Shllak	Uk-Bibaj
21	Shkodër	Shllak	Vukjakaj-Gegaj
22	Shkodër	Shllak	Vukaj
23	Shkodër	Postribë	Shokotë
24	Malësi e Madhe	Gruemirë	Kurte
25	Malësi e Madhe	Gruemirë	Linaj-EGC-Lepurosh
26	Malësi e Madhe	Gruemirë	Gjorm
27	Malësi e Madhe	Gruemirë	Meshqerrë
28	Malësi e Madhe	Gruemirë	Ktosh
29	Malësi e Madhe	Gruemirë	Grude Fushë
30	Malësi e Madhe	Gruemirë	Gruemirë

31	Malësi e Madhe	Gruemirë	Omaraj
32	Malësi e Madhe	Gruemirë	Grile
33	Malësi e Madhe	Gruemirë	Boric i Vogël
34	Shkodër	Rrethina	Guci e Re
35	Shkodër	Rrethina	Shtoj i Ri
36	Shkodër	Rrethina	Shtoj i Vjetër

8. Intensifikimin e kontrollit veterinar në fermat që mbarështojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar të Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj